



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:174565
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05458757

C.nr.1129/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Blerina KURTAJ, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj Thaqi, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit A.C., nga Gjakova, rr. "...", p.nr., kundër të paditurve S.P., B.I.- NPT "S.P.", me numër unik të biznesit 811132513, me seli në Gjakovë, rr. "M...", nr.12, me pronarë S.B., dhe XH.B., B.I.-DPT "...", me numër unik të biznesit 810244608, me seli në Gjakovë, rr. "...", p.nr., me pronar XH.B., me objekt kontesti: për detyrim, vlera e kontestit 900.00 Euro, jashtë seancës, me 15 Mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura kontestimore e udhëhequr sipas shenjës C.nr.1129/21, për shkak të vdekjes së të paditurit të parë S.B., ish nga Gjakova.

A r s y e t i m

Paditësi A.C., nga Gjakova, rr. "... p.nr., me datë 05.08.2021 ka parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve S.P., B.I.- NPT "...", me numër unik të biznesit 811132513, me seli në Gjakovë, rr. "M. Grameno", nr.12, me pronarë S.B., dhe XH.B., B.I.-DPT "...", me numër unik të biznesit 810244608, me seli në Gjakovë, rr. "...", p.nr., me pronar XH.B., për detyrim.

Gjykata është njoftuar se i padituri i parë ka vdekur e këtë fakt e vërtetoj përmes certifikatës së vdekjes me numër reference 2/2024RV/2001, numër rendor 15, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, me datë 12.02.2024.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 277 pika (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilin është paraparë se: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim*”, vendosi që ta ndërpres procedurën kontestimore në këtë çështje juridike kontestimore, ndërsa e njëjta do të vazhdoj kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

Andaj gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1129/21, me 15 mars 2024

GJYQTARJA

Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Numri i lëndës: 2021:174565
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05458757